

VENDIM
Nr. 534, datë 12.8.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 322, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE
ADMINISTRATIVË NË AGJENCINË SHETETËRORE TË KADASTRËS”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 322, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, fillojnë nga momenti i emërimit/transferimit të nëpunësve në detyrë dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2024, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 2

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve
të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në
drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune)
Titullar i drejtorive vendore	III-1	1	20 000
Zëvendëstitullar i drejtorive vendore	III-2	1	18 000
Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore	IV-1	1	18 000
Specialist në drejtoritë vendore	IV-2	1 ose 2 ose 3	18 000
Titullar i zyrës vendore	III-3	1	18 000
Specialist në zyrat vendore	IV-3	1 ose 2 ose 3	18 000

Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë:

Berat, Dibër, Durrës–Kavajë–Krujë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kamzë–Vorë, Korçë–Devoll–Kolonjë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Qendra e Kadastrës Digjitale, Sarandë, Shkodër, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Vlorë, zonat e simuluar.

Zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (sipas rendit alfabetik) janë:

Bulqizë, Malësi e Madhe, Mat.